



Bazuar në nenin 44 të Ligjit për Policinë e Kosovës, Nr. 04/L-076, Rregulloren (MPB) Nr.02/2023 për Organizimin dhe Sistematizimin e vendeve të punës të Policisë së Kosovës, Udhëzimin Administrativ 02/2023 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës neni 26, si dhe aprovimin e Drejtorit të Përgjithshëm datë: **24/11/2025** me nr ref: DBN **10/1-01/154/2025**, Policia e Kosovës shpall:

## K O N K U R S

Datë: **01.12.2025**

Referenca: **10/1-01/SRS/0779/2025**

### **Për plotësimin e vendit të punës**

1. **Titulli i vendit të punës:** Zyrtar i Lartë i të Hyrave - dy (2) vende të lira pune

**Vendi i punës:** Sektori i të Hyrave -Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, Departamenti i Shërbimeve Mbështetëse.

**Klasa:** Profesional I

**Koeficienti:** 5.7

Për vitin 2025 zbatohet ligji nr.08/L-332 nenit 33 paragrafi 2 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës.

**Kohëzgjatja e emërimit:** Me afat të pa caktuar

**Orari i punës:** I plotë

### **Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Në bashkëpunim me mbikëqyrësin harton planet e punës për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave dhe jep rekomandime lidhur me realizimin e këtyre;
- Mbështetja në hartimin e planeve buxhetore vjetore të Drejtorisë, koordinimi i punëve me zyrtarët përkatës brenda Drejtorisë për të siguruar që planet kompletohen me përpikëri dhe sipas afatit;
- Analizon dhe vlerëson propozimet buxhetore dhe bënë ekzaminimin e tyre duke shqyrtuar korrektësinë, saktësinë dhe tërësinë si dhe kontribuon në përgatitjen e buxhetit përfundimtar për njësinë buxhetore në përputhje me ligjin dhe rregullat financiare të Thesarit;
- Ofron këshilla dhe udhëzime për mbikëqyrësin dhe barazon llogaritë e të hyrave të drejtorisë për buxhet dhe financa sipas kodeve ekonomike për të gjitha linjat buxhetore që krijojnë të hyra për çdo tremujorë të vitit fiskal;
- Bënë planifikimin, koordinimin, evidentimin, realizimin, barazimin dhe raportimin e të hyrave të Policisë së Kosovës sipas Departamenteve dhe llojeve të të hyrave, si dhe zbatimin e politikave për të hyra bazuar në legjislacionin në fuqi;

- Pranon raportet nga Thesari përmes terminalit ( File-in e ICS-sit dhe nga BQK-ja - Bankat Komerciale dhe Institucionet Financiare Jo bankare) përpunon, shpërndan këtë raport tek zyrtarët e tjerë të barazimit të të hyrave;
- Bënë verifikimin, plotësimin e sistemeve të brendshme ( data bazave ) të të hyrave të Policisë se Kosovës dhe bazuar kërkesës nga Departamentet, Divizionet, Drejtorit dhe Sektorët ne kuadër te PK-së bëjnë kërkesën për gjenerim të Uniref - it në Thesar për çdo taksë që inkasohet, si dhe siguron që të jenë vendosura sistemet informative dhe procedurat për të monitoruar secilin proces të të hyrave ( nga iniciimi – lëshuarja e urdhërpagesës me Uniref për taksë dhe shërbimet te ndryshme nga zyrtarët e Departamenteve, Divizioneve, Drejtorive, Sektorëve të PK-së, deri te pagesa e faturave );
- Bënë regjistrimin e të hyrave në SIMFK, dhe barazon librat e evidencës të të hyrave të PK-së sipas Departamenteve, Divizioneve, Drejtorive, Sektorëve me librat e MFPT – Thesarin ( SIMFK );
- Bënë bashkëpunim të ngushtë me Thesarin, Divizionin e te Hyrave ne kuadër te MPB-se për barazime te te hyrave dhe raportime sipas nevojave dhe kërkesave gjatë përpilimit dhe konsolidimit të pasqyrave buxhetore të të hyrave, bashkëpunon me BQK-në, Bankat Komerciale dhe Institucionet Financiare Jo bankare, si dhe me akterët tjerë brenda MFPT-ës sa i përket të hyrave dhe donacioneve, bashkëpunimi me auditorin e brendshëm dhe të jashtëm gjatë procesit të Auditimit;
- Përkujdeset që prioritetet lidhur me planifikimin e të hyrave në Kornizën Afatmesme te Shpenzimeve të jenë në harmoni me prioritetet e Qeverisë;
- Bënë realizimin e kthimit të mjeteve kur lënda procedohet gabim nga zyrtarët e PK-së, kthimi i mjeteve nga vendimet e komisionit për vendosje dhe kur mjetet realizohen dhe raportohen gabimisht nga Bankat Komerciale dhe Institucionet Financiare jo bankare;
- Është përgjegjësi dhe detyre që gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare të angazhohet në mbledhjen e informatave të inteligjencës nga të gjitha burimet në dispozicion;
- Kryen edhe punë tjera që ia përcakton mbikëqyrësi i drejtpërdrejt në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, të cilat me arsye mund të kërkohen kohë pas kohe dhe të cilat nuk cenojnë dinjitetin e punonjësit.

### **Shkollimi i kërkuar dhe shkathtësitë:**

- Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite adekuate të studimeve- ekonomik, financa apo kontabilitet;
- Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në klasën Profesional 2;
- Njohuri të thella në lëmin e buxhetit dhe financa publike;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi;
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësinë për të krijuar dhe mbajtur marrëdhënie mirëbesimi me eprorin dhe stafin që e menaxhon, aftësi për të motivuar stafin;
- Aftësi organizative dhe drejtuese për të menaxhuar dhe për t'iu përshtatur prioritetëve dhe kërkesave, afateve kohore përmes aftësive analitike dhe zgjidhjes së problemeve;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim te rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, PowerPoint, Access

## **Kërkesat e përgjithshme për pranim janë:**

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të kenë nivelin e arsimit dhe përvojën e punës të kërkuar për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës;
- Te ketë integritet personal dhe vlera te larta etike;
- Të kalojnë me sukses procedurat e pranimit.

## **Forma e aplikimit:**

Aplikimi mund të bëhet në dy mënyra:

1. Aplikimi online ose
2. Aplikimi në formë fizike.

- 1. Aplikimi online** bëhet përmes ueb faqes zyrtare të PK-së: [www.kosovopolic.com/](http://www.kosovopolic.com/) Shpallje/ Mundësi punësimi.

**Në aplikimin online duhet bashkangjitur dokumentet e kërkuara si:**

- a) Kopja e diplomës për arsimin e kërkuar, ndërsa për kandidatët që kanë përfunduar shkollimin jashtë vendit kopjen e diplomës e nostrifikuar;
- b) Dëshmi për kualifikime tjera, dëshmi për përvojën e punës;
- c) Certifikata e Gjendjes Penale (jo me i vjetër se 6 muaj);
- d) Një fotografi të formatit (5 x 5).

- 2. Aplikimi në formë fizike** - Formularët për aplikim janë në dispozicion në ueb-faqen e Policisë së Kosovës [www.kosovopolic.com](http://www.kosovopolic.com) ku gjendet shpallja e konkursit.

**Në aplikimin në formë fizike duhet bashkangjitur dokumentet e kërkuara si:**

- a) Formulari për aplikim se bashku me Deklarata (lidhur me pajtueshmërinë e hetimeve të së kaluarës), mund ta shkarkoni në ueb-faqen e Policisë së Kosovës [www.kosovopolic.com](http://www.kosovopolic.com);
- b) Kopja e diplomës për arsimin e kërkuar, ndërsa për kandidatët që kanë përfunduar shkollimin jashtë vendit kopjen e diplomës e nostrifikuar;
- c) Dëshmi për kualifikime tjera, dëshmi për përvojën e punës;
- d) Çertifikata /ekstraktin e lindjes (jo me i vjetër se 6 muaj);
- e) Çertifikata e gjendjes penale (jo me i vjetër se 6 muaj);
- f) Kopja e letërnjoftimit ose pasaportës valide;
- g) Një fotografi të formatit (5 x 5).

Formularët duhet t'i dorëzohen në Sektorin për Rekrutim dhe Seleksionim, Ndërtesa e re e Administratës, DPP, Prishtinë, personalisht ose dërgohen me postë në këtë adresë: **Policia e Kosovës, rr. "Luan Haradinaj", 10000 Prishtinë, Sektori për Rekrutim dhe Seleksionim, kati i III, zyra 54**, çdo ditë pune nga ora 09:00-15:00 deri në afatin e fundit për konkurrim. Dokumentet e pranuar nuk do të kthehen!  
Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen.

#### **Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin:**

Bazuar në aktet ligjore të lartpërmendura të gjitha aplikacionet dhe dokumentacioni i pranuar do të shqyrtohet me kujdes dhe gjatë shqyrtimit nëse konstatohet se kandidati nuk i plotëson kriteret e përcaktuara për aplikim dhe punësim, apo nëse aplikacioni përmban të dhëna të rrejshme kandidati menjëherë do të diskualifikohet.

Kandidatët e suksesshëm do të ftohen të marrin pjesë në testimin me shkrim dhe me gojë. Kandidatët që kalojnë testin me shkrim do t'i nënshtrohen intervistës. Këto pozita i nënshtrohen procesit të verifikimit dhe mund të plotësohet vetëm pas përfundimit të suksesshëm të procesit të verifikimit.

Kandidatët të cilët kanë ndonjë vërejtje në procesin e rekrutimit dhe seleksionimit për çdo fazë të testimit, kanë të drejtë të ankohen.

Informimi i kandidatëve lidhur me çdo faze të testimit do të bëhet përmes publikimit të listave në ueb - faqen e Policisë së Kosovës, në adresën: [www.kosovopolic.com](http://www.kosovopolic.com), te rubrika mundësi e punësimit.

#### **Data e fillimit dhe e mbylljes së konkursit:**

Konkursi do të jetë i hapur 15 ditë nga data **01.12.2025** deri me **15.12.2025**

**Numrat kontaktues:** Për informata plotësuese mund të thirrni në numrin e telefonit kontaktues nr.: 038-5080 1002 / 038-504504 1751 dhe 038-245184 si dhe në adresën elektronike [rekrutimi@kosovopolic.com](mailto:rekrutimi@kosovopolic.com).

***“Policia e Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë, si dhe personat me aftësi të kufizuara”.***